



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Prot. 261 Nr.

Durrës, më 5 / 2 / 2024

VENDIM

NR 2, datë 5 / 2 / 2024

PËR

"HAPJEN E PROCESIT TË APLIKIMEVE MBI PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM TË DHËNIES SË GRADËS SHKENCORE "DOKTOR", PRANË FAKULTETIT TË SHKENCAVE POLITIKE JURIDIKE, NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"

Në mbështetje të ligjit, Nr. 80/2015, datë 17/09/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës", e miratuar me vendim Senati Akademik nr.43, datë 11.02.2020, të Urdhrit të Rektorit nr. 419 datë 13.11.2023 "Për shpalljen e zgjedhjeve për anëtar të Komisionit të Përhershëm të Dhënies së Gradës Shkencore "Doktor", pranë Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës", të Urdhrit të Rektorit nr. 45 datë 2.2.2024 "Për shpalljen e zgjedhjeve për plotësimin e vendit vakant anëtar të Komisionit të Përhershëm të Dhënies së Gradës Shkencore "Doktor", pranë Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës", Komisioni Institucional i Zgjedhjeve,

VENDOSI:

1. Hapjen e procesit të aplikimeve për plotësimin e vendit vakant anëtar të Komisionit të Përhershëm të dhënies së gradës shkencore "Doktor", pranë Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës.
2. Regjistrimi i kandidatëve, do të zhvillohet nga data 05.02.2024 deri në datën **12.02.2024**, orari **08.00 – 16.00**, pranë Sekretarisë KZF Shkencave Politike Juridike, salla 016, Godina nr. 2.
3. Bashkëlidhur vendimit dokumentacioni i cili do të dorëzohet për aplikim.
4. Data e zhvillimit të zgjedhjeve do të jetë data **04.03.2024**.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gentian Ruspi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

KËRKESË PËR KANDIDIM

PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR DHËNIEN E GRADËS
SHKENCORE "DOKTOR" NË FAKULTETIN E SHKENCAVE POLTIKE JURIDIKE

Unë i/e nënshkruar/a _____, lindur më ____/____/____, në
_____, të rrethit _____, gjinia _____, staf akademik në
Departamentin _____, Fakulteti _____ paraqes kërkesën time për të
kandiduar si anëtar i Komisionit të Përherëshëm për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" në
Fakultetin e Shkencave Politike Juridike UAMD.

Deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

- Nuk jam dënuar asnjëherë gjatë jetës time, me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë vepër penale.
- Nuk kam asnjë shkak për të qenë objekt i ligjit nr, 136/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"
- Nuk kam asnjë shkak për të qenë objekt i ligjit 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentat e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.
- Nuk është caktuar ndaj meje asnjë nga masat e sigurimit personal
- Nuk është dhënë ndaj meje asnjë mase disiplinore e cila është në fuqi

Kësaj kërkesë i bashkangjitet, kopja e kartës së identitetit/pasaportës, kopja e noterizuar e titullit _____ që unë zotëroj, vërtetimi i qendrës time të punës, vetëdeklarimi për integritetin e lartë akademik, vetëdeklarimi gjendjes gjyqësore.

Për sa deklaroja në këtë kërkesë mbaj përgjegjësi personale dhe autorizoj Komisionin Institucional të Zgjedhjeve të bëjë verifikimet që ai i konsideron të nevojshme.

Aplikuesi

U dorëzua sot, më datën _____, në zyrën _____, tek sekretaria e KZF _____, (firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” Durrës
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Dokumentacioni për kandidim:

- a) Kërkesën për kandidim, e cila përmban, emrin; atësinë; mbiemrin; datëlindjen; gjininë; shprehjen e vullnetit për kandidim;
- b) Vetëdeklarim për integritetin e lartë akademik të kandidatit
- c) Deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale;
- d) Deklarimin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- e) Kopje të dokumentit të identifikimit;
- f) Kopje të noterizuar të titullit akademik, “Profesor” ose “Profesor i asociuar” dhe diplomës/diplomave të arsimit të lartë;
- g) Fotokopje të noteruar të librezës së punës.(Vërtetimi i punës)